

Osmani njofton për shtyrjen e afatit për aplikimin e njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ZYRTARI I LARTË AMERIKAN DHE AI EVROPIAN MARRIN PJESË NË KONFERENCËN E BE-së PËR RRIJTJEN EKONOMIKE TË RAJONIT

SHBA-ja, LIDERËVE TË BALLKANIT: S'MUND TA PENGONI RRUGËTIMIN E NJËRI-TJETRIT DREJT BE-së



Liderët e Ballkanit Perëndimor kanë shprehur gatishmëri për t'i zhvilluar vendet e tyre sipas standardeve evropiane. Në konferencën e BE-së për rritjen ekonomike të rajonit që është mbajtur të hënën në Shkup, liderët e Ballkanit janë

paralajmëruar se nuk do të mund t'i vendosin njëri-tjetrit veto përgjatë procesit të integritetit në BE dhe se nëse do të ketë tendenca të tilla, ata do të ndëshkohen. Zyrtari i lartë i ShBA-së, James O'Brien, i cili ka marrë pjesë në këtë konferencë,

ka thënë se Ballkani Perëndimor asnjëherë nuk kanë qenë më afër anëtarësimit në BE, por që kanë ende punë përpara. Po ashtu, ai u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë ta zbatojnë plotësisht marrëveshjen e Ohrit

PËRFUNDON MBLEDHJA E NËNSHKRIMEVE PËR LARGIMIN E KRYETARËVE SHQIPTARË NË VERI

F. 3



VRASJA E TË RIUT NË PODUJEVË, IPK-ja NIS HETIMIN PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT TË RASTIT NGA POLICIA

F. 7



KEDS-i VJET KAPI 6 715 KONSUMATORË DUKE VJEDHUR RRYMËN, NJËRI NGA TA VODHI MBI 52 MIJË EURO

F. 8

OPERACIONI 'TEMPULLI 2', GODITEN SHTATË GRUPE KRIMINALE DHE ARRESTOHEN 273 PERSONA

F. 8

SPORT



RAMA SOT DO T'I PARAQESË 20 PROJEKTE PËR KRYEQYTETIN

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

DeSantis tërhiqet nga gara për president të ShBA-së

NJU-JORK, 22 JANAR - Guvernatori republikan Ron DeSantis ka pezulluar fushatën e tij për president të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), duke u tërhequr nga gara. Ky vendim ka ardhur dy ditë përpara zgjedhjeve paraprake në New Hampshire.

DeSantis njoftimin për tërheqjen nga gara e ka bërë në një video të publikuar në platformën “X”. “Nuk mund t’u kërkoj mbështetësve tanë të japin vullnetarisht kohën e tyre të përkushtohen plotësisht, kur ne nuk e kemi të qartë rrugën drejt fitores dhe aq më pak të sigurt. Prandaj sot po e pezulloj

fushatën time. Është e qartë për mua se shumica e votuesve republikanë duan t’i japin Donald Trump një shans tjetër. Ai ka mbështetjen time sepse ne nuk mund të kthehemi te garda e vjetër republikane e dikurshme, apo ripaketimi i formuar që përfaqëson Nikki Haley”, ka thënë DeSantis.



OKB-ja merr në pyetje Rusinë për fatin e fëmijëve ukrainas

NJU-JORK, 22 JANAR - Organizata e Kombeve të Bashkuara do të kërkojë të hënën nga Moska që të sqarojë se çfarë ka ndodhur me mijëra fëmijë ukrainas që besohet se janë dërguar me forcë në Rusi prej nisjes së luftës në Ukrainë.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Fëmijëve, 18 ekspertë të pavarur – pritet t’i vlerësojnë dëshmitë e Ruses për dy ditë. Lista e tyre e gjatë e shqetësimeve i është dërguar Moskës në gjysmën e parë të vitit 2023.

Ata dëshirojnë të dinë sa fëmijë janë “evakuuar” në Rusi apo brenda territorit ukrainas të pushtuar prej Ruses. Ekspertët kanë thënë se dëshirojnë të

dinë se çfarë ka bërë Moska për të mbrojtur “të drejtën e këtyre fëmijëve për ta ruajtur identitetin, përfshirë kombësinë, emrin dhe marrëdhëniet familjare”.

Kievi ka vlerësuar se 20 mijë fëmijë ukrainas janë dërguar me forcë në Rusi. Moska ka thënë se dëshiron t’i mbrojë këta fëmijë prej luftimeve.

Deri më tani vetëm rreth 400 fëmijë janë riatdhesuar. Rusia pati thënë në disa përgjigje me shkrim në tetor se vendet për fëmijët e evakuuar janë të caktuara dhe lëvizjet bëhen me miratimin e tyre.

Autoritetet ruse nuk kanë treguar numrin total të fëmijëve të marrë prej Ukrainës, mirëpo ka përmendur se aty përfshihen



fëmijët jetimë dhe fëmijët pa përkujdesje prindërore.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën

“operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën. Përfundimi është përgjigjur ndaj Ruses, duke goditur ekonominë e këtij shteti me

sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Australia shfuqizon skemën e ‘vizave të arta’ për të pasurit



CANBERRA, 22 JANAR - Australia ka shfuqizuar skemën e të ashtuquajturave “viza të arta” të cilat u kanë mundësuar investitorëve të pasur të jetojnë në këtë vend.

Ndonëse synim kishte tërheqjen e investimeve të huaja, zyrtarët qeveritarë kanë gjetur së fundi se skema ka prodhuar “rezultate të dobëta ekonomike”.

Kritikët kanë argumentuar për kohë të gjatë se skema është shfrytëzuar prej “zyrtarëve të korruptuar” për të ruajtur mjetet e fituara në mënyrë ilegale. Kjo skemë tani do të zëvendësohet me një program të vizave për punëtorë të kualifikuar.

Mijëra viza janë dhënë në kuadër të programit për të pasurit qysh prej vitit 2012 dhe, pothuajse, 85 për qind e aplikimeve të suksesshme kanë qenë prej Kinës, sipas të dhënave qeveritare. Skema ka paraparë që kandidatët që kanë fituar këtë vizë është dashur të investojnë në Australi 3.3 milionë dollarë amerikanë. Edhe Mbretëria e Bashkuar ka vepruar njëjtë më 2022, duke u dhënë fund skemave që u mundësojnë të pasurve lehtësim të procedurave për qëndrim, pas shqetësimeve për qarkullim të parave të pista ruse në territorin e saj.

Zelensky propozon dhënien e nënshtetësisë ukrainase për të huajt që mbrojnë Ukrainën

Kiev, 22 janar - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy, ka propozuar që luftëtarëve të huaj që janë duke luftuar për shtetin e tij t’u jepet shtetësia ukrainase. Ai ka thënë se nga kjo reformë ligjore do të përfitojnë “luftëtarët e huaj që erdhën

për ta mbrojtur Ukrainën, ata që po luftojnë për lirinë e Ukrainës sikur të ishte atdheu i tyre”. “Gjithashtu edhe personat me origjinë ukrainase dhe pasardhësit e tyre në mbarë botën do ta kenë shtetësinë tonë, me përjashtim të qytetarëve të

shtetit agresor”, ka thënë ai. Mijëra të huaj kanë shkuar në Ukrainë për të luftuar kundër Ruses e cila më 24 shkurt të vitit 2022 ka nisur pushtimin e shtetit fqinj. Moska i quan ushtarët e huaj mercenarë dhe si provë se NATO po bën një luftë kundër Ruses.



Rama: Zelensky do të vijë në Tiranë e do të organizojmë samit për Ukrainën

SHKUP, 22 JANAR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka njoftuar për zhvillimin e një samiti për Ukrainën në Tiranë, në të cilin do të jetë i pranishëm edhe presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky. Gjatë një bashkëbisedimi me qytetarë nga Shkupi, ku ishte pjesë e tryezës së liderëve të

Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësuesve të lartë të administratës amerikane e të BE-së, Rama ka treguar për zhvillimin e këtij samiti të veçantë. “Po përgatisim një samit për Ukrainën. Do të kemi të pranishëm presidentin Zelensky. Paralelisht me të, do të përpiqemi që në atë hark

kohor ta kemi edhe takimin tjetër të liderëve të rajonit, me përfaqësuesit e sotëm dhe që janë ata që do të ndjekin këtë pjesë të Komisionit Evropian dhe përfaqësuesve amerikanë, për të vazhduar të punojmë me ritmin e përshpejtuar që dikton që janë sot në Evropë”, ka thënë Rama.



Përfundon mbledhja e nënshkrimeve për largimin e kryetarëve shqiptarë në veri

PRISHTINË, 22 JANAR - Nënshkrimi i peticioneve, i cili do ta hapte rrugën për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në katër komuna në veri të Kosovës, tashmë ka përfunduar. Këtë e kanë konfirmuar për Radion Evropa e Lirë përfaqësues të grupeve të cilat e kanë iniciuar këtë proces. Darko Vuksanović nga grupi për Zveçanin ka konfirmuar për “REL”-in se është mbledhur numër i mjaftueshëm i nënshkrimeve. Në Komunën e Zubin Potokut, ku nënshkrimi është kryer gjatë periudhës 19-22 janar, janë mbledhur mjaft nënshkrime, ka konfirmuar Sërgjan Vuçiniq, një nga iniciatorët. Paraprakisht, edhe Sanja Kërtiniq, nga grupi iniciator në Mitrovicën e Veriut, ka thënë se procesi i mbledhjes së nënshkrimeve ka përfunduar. Të shtunën, më 20 janar, janë mbledhur nënshkrime të mjaftueshme edhe në komunën e Leposaviqit. Iniciatorët e nënshkrimit të peticioneve nuk kanë specifikuar se sa qytetarë kanë nënshkruar, duke thënë vetëm se janë mbledhur më shumë nënshkrime se minimumi i kërkuar. Në komunën e Mitrovicës së Veriut peticionin është dashur ta nënshkruajnë së paku 3 640 votues me të drejtë vote, në Leposaviq 2 689 votues, në Zveçan 1 411 votues dhe në Zubin Potok 1 347 votues, shifra që përbëjnë 20 për qind të numrit të përgjithshëm të votuesve në këto komuna. Hapi i radhës tani është që peticionet e votuesve të regjistruar t'u dorëzohen kryetarëve të kuvendeve komunale.



Pas dorëzimit të peticionit me nënshkrime, kryetari i kuvendit ka tri ditë kohë për t'ia përcjellë atë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shqyrtim dhe verifikim. Nëse KQZ-ja konfirmon se nënshkrimet e mbledhura janë të përshtatshme dhe i verifikon ato, organizohet votimi për shkarkimin e kryetarit, i cili duhet të mbahet brenda 45 ditëve. Që ky votim të jetë i suksesshëm, kërkohet 50 për qind plus një votë e qytetarëve me të drejtë vote. Pas kësaj, rezultati i dërgohet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka afat ligjor prej 30 deri në 45 ditë për të

shpallur zgjedhje të parakohshme. Kryetarët shqiptarë u zgjedhën në prill të vitit 2023, në zgjedhjet që u bojkotuan nga serbët, në shenjë pakënaqësie me politikat e Qeverisë së Kosovës. Nisja e detyrës së tyre nxiti tensione në fund të majit të vitit të kaluar, të cilat kulmuan në Zveçan, pasi protestuesit serbë u përleshën me pjesëtarët e misionit paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë - KFOR. Bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar uljen e tensioneve dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja në

katër komunat në veri të Kosovës. Peticioni është nënshkruar edhe nga përfaqësuesit e Listës Serbe, parti që bojkotoi zgjedhjet dhe largoi përfaqësuesit e saj nga institucionet e Kosovës, duke nxitur edhe largimin e serbëve të tjerë. Largimi nga institucionet u bë në shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me ndërrimin e targave të makinave nga ato të lëshuara nga Serbia në ato që lëshohen nga Kosova, por që atëherë kjo çështje është zgjidhur. Por, në mesin e tetorit të vitit 2023, kjo parti deklaroi se ishte e gatshme të merrte pjesë në zgjedhjet në

komunat në veri, pa vendosur asnjë kusht për pjesëmarrje në zgjedhje, siç kishte bërë më herët. Ky qëndrim i kësaj partie u mor pasi presidenti serb Aleksandër Vuçiç u bëri thirrje përfaqësuesve serbë në veri të Kosovës që ta inicionin mbajtjen e zgjedhjeve të reja në mënyrë që “levat kryesore të pushtetit të jenë në duart e tyre”. Kësaj thirrjeje i parapriu një sulm i armatosur në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator, kur një grup serbësh sulmuan Policinë e Kosovës, duke vrarë një polic. Përgjegjësinë për sulmin e mori ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiq.

Osmani njofton për shtyrjen e afatit për aplikimin e njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës

Prishtinë, 22 janar - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë vendim për shtyrjen e afatit për aplikim të njohjes së statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës. Osmani ka bërë me dije se afati është shtyrë deri më 15 maj të vitit të ardhshëm. Ajo u ka bërë thirrje qytetarëve të aplikojnë për

njohjen e statusit, duke thënë se e vërteta duhet të dëgjohet. Më tutje, Osmani ka thënë se do të qëndrojnë afër viktimave dhe do të bëjnë të pamundurën për ndjekjen e drejtësisë. “Zëri juaj ka rëndësi dhe e vërteta duhet të dëgjohet. Guximi juaj në kërkim të drejtësisë e në

zbardhjen e së vërtetës është një dëshmi e shpirtit tuaj të paepur. Ne qëndrojmë në ju dhe pranë jush në ndjekjen e drejtësisë. Në këtë rrugëtim ju asnjëherë nuk do të jeni vetëm! Prandaj, aplikoni për njohjen e statusit të viktimës së dhunës seksuale të luftës”, ka thënë Osmani.





ZYRTARI I LARTË AMERIKAN DHE AI EVROPIAN MARRIN PJESË NË KONFERENCËN E BE-SË PËR RITJEN EKONOMIKE TË RAJONIT

ShBA-ja, liderëve të Ballkanit: S'mund ta pengoni rrugëtimin e njëri-tjetrit drejt BE-së

Liderët e Ballkanit Perëndimor kanë shprehur gatishmëri për t'i zhvilluar vendet e tyre sipas standardeve evropiane. Në konferencën e BE-së për rritjen ekonomike të rajonit që është mbajtur të hënën në Shkup, liderët e Ballkanit janë paralajmëruar se nuk do të mund t'i vendosin njëri-tjetrit veto përgjatë procesit të integrimit në BE dhe se nëse do të ketë tendenca të tilla, ata do të ndëshkohen. Zyrtari i lartë i ShBA-së, James O'Brien, i cili ka marrë pjesë në këtë konferencë, ka thënë se Ballkani Perëndimor asnjëherë nuk kanë qenë më afër anëtarësimit në BE, por që kanë ende punë përpara. Po ashtu, ai u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë ta zbatojnë plotësisht marrëveshjen e Ohrit

EPOKA E RE

Lirim GEÇI

SHKUP, 22 JANAR - Në kryeqytetin e Maqedonisë së Veriut, Shkup, është mbajtur konferenca e Bashkimit Evropian (BE) për rritjen ekonomike të rajonit. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë liderët e shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Evropën, James O'Brien. Në këtë konferencë liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë shprehur gatishmërinë për t'i zhvilluar vendet e tyre sipas standardeve evropiane dhe me një qëllim të caktuar: anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE). Kështu të paketën është thënë në deklaratën e miratuar në fund të konferencës "Plani i rritjes së Ballkanit Perëndimor dhe integrimi më i shpejtë në BE". Gjatë punimeve të kësaj konference liderët janë paralajmëruar që nuk do të mund t'i vendosin njëri-tjetrit veto përgjatë procesit të integrimit

në BE dhe se nëse do të ketë tendenca të tilla, ata do të ndëshkohen. Plani i BE-së për Ballkanin Perëndimor synon rritjen ekonomike të rajonit, përshtetimin e reformave të duhura dhe kryerjen e investimeve që mund ta avancojnë procesin e zgjerimit të BE-së me këto vende. Vlera e ndarë nga BE-ja për këtë plan për periudhën 2024-2027 është 6 miliardë euro. Nikoqiri i kësaj konference dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski, ka thënë se me planin e BE-së, brutoprodhimi i brendshëm i vendeve të Ballkanit do të dyfishohet. Ai ka thënë se fokusi në takimin e së hënës ka qenë në dy prej katër shtyllave të planit: në tregun rajonal dhe tregun e BE-së. Sipas Kovačevskit, kur vendet t'i kryejnë reformat do të hapet rruga e bizneseve për një treg të përbashkët në BE dhe vendet do të kenë qasje në ekonominë e bllokut evropian prej tre miliardë dollarësh. Për ta ilustruar më mirë rëndësinë e

planit, ai ka thënë se ekonomia e vendeve të Ballkanit përbën vetëm 0.06 për qind të ekonomisë së BE-së.

O'Brien: Me planin e BE-së askush nuk mund të vendosë veto për integrim në BE

Në këtë konferencë ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Evropën, James O'Brien, u ka thënë liderëve të Ballkanit Perëndimor se asnjëherë nuk kanë qenë më afër anëtarësimit në BE, por që kanë ende punë përpara. Në këtë kontekst, O'Brien i ka paralajmëruar liderët e Ballkanit se nuk do të kenë mundësi për ta penguar rrugëtimin e njëri-tjetrit sepse, sipas tij, nuk duhet të ekzistojnë çështje të pazgjidhura dhe se kushdo që tenton të pengojë diçka, do të përballet me ndëshkime të ashpra. "Nëse një shtet dëshiron të presë, të vëzhgojë,

atëherë qytetarët e atij shteti do të vendosin nëse këta liderë politikë janë të duhurit", ka thënë zyrtari i lartë amerikan. Sipas tij, plani i ri i BE-së dallon prej ofertave paraprake. "Plani i BE-së për rritje nuk është sikurse planet e tjera që kemi parë deri më tani. Ai thotë se jo vetëm që duhet të bëni reforma dhe të merrni buxhet më vonë. Ai thotë që nëse i bëni reformat e duhura, atëherë kompanitë dhe njerëzit tuaj do të fitojnë liri të BE-së shumë shpejt - lirinë për të lëvizur, për të punuar ku të duan", ka thënë O'Brien.

Ndërsa drejtori i Komisionit Evropian për Fqinjësi, Gert Jan Kopman, ka kërkuar angazhim më të madh të liderëve të Ballkanit për rrugën përpara, duke shtuar se BE-ja është e hapur për të ndihmuar. "Jam i inkurajuar nga përkushtimi juaj dhe kjo mund të ndodhë vetëm nëse qeveritë e rajonit vlerësojnë se ky është një prioritet i lartë, dhe vetëm nëse sigurohen se ndryshimet po ndodhin", ka deklaruar Kopman.

Kurti: Plani i rritjes ekonomike përshtet rrugën drejt BE-së

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili ka marrë pjesë në këtë konferencë, ka shprehur gatishmërinë për të punuar në drejtim të "Planit i rritjes së Ballkanit Perëndimor dhe integrimi më i shpejtë në BE". Ai ka thënë se

Kosova do ta dorëzojë listën e reformave të diskutuara, duke bërë me dije se në ditët në vijim do të dorëzohet lista e projekteve indikative.

Më tutje, Kurti ka thënë se Kosova mbështet qasjen e BE-së për kushtëzim të fondeve evropiane por, sipas tij, qarkullimi i mallrave nuk duhet të shfrytëzohet për bartje të armëve dhe sponsorizimin e sulmeve terroriste.

Kurti ka thënë se është në interesin e shtetit të Kosovës, të BE-së dhe të ShBA-së, që procesi i anëtarësimit të Kosovës në bllokun evropian të mos jetë i lidhur me dialogun Kosovë - Serbi për normalizim marrëdhëniesh.

Në dhjetor të vitit të kaluar Bashkimi Evropian (BE) i ka porositur vendet e Ballkanit Perëndimor se nuk ka më kohë për të pritur që t'i normalizojnë raportet ndërmjet tyre porse kjo duhet të bëhet shpejt si kusht për t'i shfrytëzuar mjetet nga plani për rritje ekonomike. Aktualisht Kosova dhe Serbia, nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, zhvillojnë dialog në Bruksel për normalizim marrëdhëniesh. Përparimi i tyre në dialog është përmendur si kusht për të pasur qasje në këto fonde të BE-së.

Rama kritikon BE-në në Shkup

Në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi

Rama. Ai në fjalën e tij ka përsëritur kritikën për qasjen e BE-së ndaj rajonit kur vjen puna për mbështetje ekonomike. “Duhet të paramendoni ku do të ishim nëse BE-ja do të ishte më serioze me integrimin rajonal. Është e rëndësishme të kuptohet që integrimi është një sfidë goxha e madhe dhe përfitimi i madh. Përpjekjet për konvergencë janë patetike dhe ky është fakt. Një nga vendet fqinje merr nga BE-ja rreth 400 mijë për qytetar, ndërsa ne këtu marrim rreth 130 për qytetar. Ekziston dëshpërim në këtë drejtim. Gjatë viteve kemi ardhur në këtë pikë. Nëse duam të jemi të gatshëm duhet të sakrifikoni të jepni diçka për veten”, ka thënë Rama, duke shtuar se “duhet ta harrojmë ngjyrën e flamujve të grindjeve. Flamuri ynë duhet të jetë ai i BE-së”. “Kur BE-ja është në formë të mirë ne jemi në formë të keqe. Kur ne jemi në formë të mirë ata janë në formë të keqe. Nuk duhet të mbahemi mend për sherret mes vete, por për ato gjëra të mira në ndihmë të bizneseve dhe për të gjithë qytetarët tanë. Bosnja duhet ta ratifikojë marrëveshjen e kështu qytetarët e Kosovës do të lëvizin lirshëm”, ka thënë Rama.

Në këtë konferencë, Rama ka adresuar edhe një propozim. “Të vendosim një rreth politik siç kishim mbrëmë, të takohemi rregullisht. Jemi ballkanas dhe nëse nuk vini për të na ulur bashkë në një tryezë, mund t’i bëjmë punët pis. Të kemi mesazh të qartë nga liderët që duhet të harrojmë historinë, duhet ta harroni se cila ngjyrë është e flamurëve tona. Ngjyra më e rëndësishme duhet të jetë e flamurit të BE-së. Nëse duam ta realizojmë dhe mos ta humbim këtë mundësi”, ka thënë Rama.

Kurse presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se takimet e këtilla janë të rëndësishme për zhvillimin e rajonit. “Sa i përket Serbisë ne e kemi paraqitur planin tonë për rritjen ekonomike për tre vjetët e ardhshëm dhe përputhet me atë që po bëjmë me BE-në. Ne do të bëjmë gjithçka që reformën ta bëjmë që të mund të kemi qasje në mjetet financiare sa më shpejt që të jetë e mundur, së bashku me gjithë të tjerët. Besoj se të gjithë së bashku, duke punuar në këtë plan, do të bëjmë përparim të madh”, ka thënë Vuçiq.

Një ditë para kësaj konference kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski, kishte mbledhur në një darkë pune liderët e Ballkanit së bashku me përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në këtë darkë kanë qenë të pranishëm lideri i BDI-së, Ali Ahmeti dhe zëvendëskryeministri i parë i Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi.

Çfarë është plani për rritjen ekonomike në Ballkanin Perëndimor?

Plan i ri për rritje ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, i miratuar nga Komisioni Evropian, më 8 nëntor të vitit 2023, është i bazuar në katër shtylla.

Shtylla e parë është “forcimi i



integritimit ekonomik në tregun unik të BE-së”. Kjo do të varet nga përshtatja e vendeve të rajonit me rregullat e tregut unik dhe paralelisht hapja e tregut të tyre në sektorët përkatës për vendet fqinje. Shtylla e dytë e këtij plani është “forcimi i integritimit ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor përmes tregut të përbashkët rajonal”. Kjo, sipas përvojës së BE-së, do të ndikojë në një rritje potenciale ekonomike prej 10-përqindësh. Shtylla e tretë e këtij plani është “përsheptimi i reformave fundamentale”. Kjo nënkupton sundimin e ligjit që ndihmon edhe në tërheqjen e investimeve direkte të huaja dhe forcon stabilitetin rajonal. Shtylla e katërt e planit të ri të Komisionit Evropian për rritje

ekonomike në Ballkanin Perëndimor është “rritja e asistencës financiare për t’i ndihmuar reformat”. Këtu përfshihet edhe propozimi për 6 miliardë euro ndihmë. Pasi vendet e rajonit në raportet tregtare me Bashkimin Evropian përfitojnë edhe nga marrëveshjet përkatëse të stabilizim-asociimit, KE-ja propozon të shkohet edhe përtej kësaj, duke bërë edhe ndryshime në këto marrëveshje për të mundësuar kushte të barabarta në treg dhe mes vendeve në procesin e zgjerimit dhe vendeve anëtare të BE-së. Të gjitha këto qëllime janë në përputhje edhe me idetë që po realizohen përmes Procesit të Berlinit si dhe krijimin e “tregut të përbashkët rajonal”.

O’Brien, mesazh Kurtit dhe Vuçiqit: Të dyja shtetet të angazhohen për zbatimin e marrëveshjes së Ohrit

Ndihmësekretari i Shtetit, James O’Brien, në një konferencë për medie pas konferencës “Plani i rritjes së Ballkanit Perëndimor dhe integrimi më i shpejtë në BE”, ka folur shkurtimisht edhe për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se ShBA-ja e përkrah fuqishëm marrëveshjen e Ohrit që është aritur në mars të vitit të kaluar në Maqedoni të

Veriut. Në këtë drejtim, ai ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet të veprojnë brenda dialogut për ta zbatuar plotësisht Marrëveshjen e Ohrit. “Ne mbështesim fuqimisht udhërrëfyesin e Ohrit, që është miratuar në mars të vitit të kaluar dhe të dy shtetet duhet të veprojnë brenda dialogut për ta zbatuar plotësisht”, ka thënë O’Brieni.

Kurti: Masat e sigurisë ndaj Serbisë nuk mund t’i heqim, terroristët po veprojnë të lirë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka mbajtur një konferencë për medie në Shkup, pasi ka përfunduar takimi me BE-në lidhur me planin e ri të financimit mbi 6 miliardë eurosh. Kurti ka thënë se Kosova ka masa të sigurisë ndaj Serbisë, e jo masa tregtare, për shkak të armatimit të vazhdueshëm që hyn nga Kosova.

Ai ka thënë se nuk do të hiqen këto masa përderisa kanë informacione se grupi terrorist i Banjskës vazhdon të riorganizohet. “Tregu i përbashkët rajonal është thelbi i procesit të Berlinit, ndërkaq me planin e rritjes do të avancojmë më tej. Do të rritet pjesëmarrja dhe qasja në tregun unik të BE-së. Ne nuk kemi masa tregtare ndaj Serbisë, por kemi masa të sigurisë, sepse në vitin 2023 tri herë kemi pasur konfiskime masive të armatimit e municionit në veri të Kosovës. Më 23 qershor, 5 shtator dhe 24 shtator, kur na e vranë Afrim Bunjakun. I gjithë ky armatim është prodhuar në Serbi dhe ka ardhur nga Serbia. Grupi paramilitar që kreu sulmin në Banjskë të Zveçanit, pjesëtarët e tij janë të lirë në Serbi në krye me Radojiçiqin. Masat e sigurisë së Kosovës janë të domosdoshme. Kemi vetëm masa të sigurisë, jo masa tregtare. Për shkak të kontroleve të shtuara në pika kufitare, ka mundësi që edhe ndërmarrjet e caktuara nuk janë aq të interesuara ta kalojnë kufirin. Masat e sigurisë nuk mund t’i heqim përderisa grupi paramilitar është i lirë, dhe na vijnë informata se si po takohen e riorganizohen pa ndryshuar qëllimet dhe sjelljet e tyre”, është shprehur Kurti.

Më tutje, Kurti ka thënë se nuk ka ndonjë ftesë për takim të nivelit të lartë me presidentin e Serbisë. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se nuk është kollaj të bisedohet me një shtet si Serbia. “Duhet të ndahet procesi i anëtarësimit në BE,

prej normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. E di që në thelb BE-ja e ka fqinjësinë, por edhe ai duhet të na kuptojë që nuk është kollaj t’i normalizojmë raportet me dikë që nuk e ka as normalizimin e as demokratizimin shumë për qejf. Sa i përket dialogut më tutje, kjo zhvillohet në relacionin midis kryenegociatorit Besnik Bislimi dhe lehtësuesit Lajçak. Tash për tash ky është rrafshi në të cilin do të mund t’i caktojmë hapat e më tutjeshëm. Për takimin e liderëve nuk ka diçka të re, për çka ftesa na vjen nga Borrelli”, është shprehur Kurti. Kurti ka folur edhe për anulimin e një konferencë të përbashkët për medie që kishte qenë e planifikuar. “Me të përfunduar takimi u njoftuam se secili shtetas do të paraqitet para gazetarëve të veçantë dhe do të përgjigjet. Do të duhej që organizatorët të tregonin pse konferenca nuk është e përbashkët, kjo s’ka të bëjë ume Ballkanin e Hapur, sepse është Bashkimi Evropian. Ballkani i Hapur nuk është mjaftueshëm evropian, kurse Ballkani Evropian është mjaftueshëm i hapur. Ballkani i Hapur nuk ka kornizë institucionale, nuk ka kontratë, nuk ka kornizë për t’i zgjidhur mospajtimet, nuk ka transparencë procesi e as informacion të publikuar. Nuk i ka as rregullat e BE-së e as financimin e BE-së”, ka thënë Kurti. Kryeministri Kurti ka thënë se Vetëvendosja nuk është parti e regjistruar në Maqedoninë e Veriut. “Kjo iu përket qytetarëve këtu, partive politike nëse do të ketë kandidat. LV-ja nuk është e regjistruar në Maqedoninë e Veriut. Ne aktivistë kemi edhe zyrtarë të partisë sonë që vijnë nga Maqedonia, mirëpo këtu nuk kemi parti të regjistruara, andaj ne si LV nuk është se marrim pjesë këtu. Dëshiroj që të ketë pjesëmarrje sa më të lartë në zgjedhje sepse kjo i kontribuon demokracisë”, ka thënë Kurti.

Nga tetori i vitit të kaluar mbi 10 mijë të qytetarë të vaksinuar në Prishtinë

PRISHTINË, 22 JANAR - Që nga tetori i vitit të kaluar 10 500 qytetarë janë vaksinuar nga gripi sezonal. Kështu ka bërë me dije mjeku specialist në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prishtinë, Naim Sveçla. Ai ka thënë se vaksinat mund të merren nga të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike. “Gjendemi në mesin e epidemisë së gripit. Interesimi si më herët nuk është. Diku 10 500 qytetarë

janë të vaksinuar. Meqenëse tani është gripi, interesimi është në rritje për vaksinë”, ka thënë Sveçla për “EO”. Më tutje, ai ka treguar edhe për grupmoshat që mund t'i marrin këto vaksinë, duke përfshirë edhe personat që u ndalohe marrja e këtyre vaksinave. “Vaksina nuk ka efekte anësore, mirëpo vaksinën nuk mund ta marrin njerëzit që kanë alergji në komponentë të proteinave të pulës ose në vezë, fëmijët nën 6

muaj dhe njerëzit që janë veç me grip ose kanë simptoma të gripit. Mirëpo është mirë që para se të vijnë ta marrin vaksinën, të konsultohen me një mjek këtu në QKMF”, ka thënë Sveçla. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve të vaksinohen. “Vaksina kemi. Duhet të rritet numri, meqenëse njerëzit e vaksinuar, përpos që e mbrojnë veten, e mbrojnë edhe rrethin, sepse nuk e përhapin gripin”, ka thënë Sveçla.



Vrasja e të riut në Podujevë, IPK-ja nis hetimin për mënyrën e trajtimit të rastit nga policia

Prishtinë, 22 janar - Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka njoftuar se ka nisur hetimin lidhur me trajtimin e rastit të tashmë të ndjerit L. F nga Policia e Kosovës. IPK-ja ka thënë se është duke grumbulluar raportet dhe provat për ta shikuar që nga fillimi i trajtimit të rastit nga policia në drejtim të zbardhjes së rrethanave të ngjarjes që kishte ndodhur më 14 janar në Podujevë, ku L. F mbeti i vdekur pas dhunës së ushtruar ndaj tij nga dy të rinj.

“Duke ju referuar kërkesës suaj ju informojmë se lidhur me këtë rast Inspektorati Policor i Kosovës sipas detyrës zyrtare ka filluar një

hetim preliminar që përfshin përveç tjerash edhe grumbullimin e informacioneve shtesë rreth veprimeve të policisë si dhe sigurimin e të gjitha shkrësive lidhur me këtë rast. Veprimet tjera do të ndërmerren varësisht nga të gjeturat e hetimit preliminar dhe autorizimeve ligjore të IPK-së” është thënë në përgjigjen e IPK-së për “Tëvël”. Pra, një vrasje në tentativë e cila ishte regjistruar më 14 janar 2024, e që në këtë rast Policia e Kosovës kishte njoftuar se ishte therur me thikë një person, ndërsa dy persona të dyshuar ishin arrestuar, ka dalë se nuk ishte zhvilluar në këtë mënyrë. Në këtë



rast nuk është duke u dyshuar se ka pasur therje me thikë, por rrahje brutale me mjete të forta (shkop druri).

Në raportin ditor të Policisë së

Kosovës të datës 15 janar thuhet se rasti ishte cilësuar vrasje në tentativë, pasi i riu ishte therur me thikë. “Janë arrestuar dy të dyshuar meshkuj kosovarë pasi

që të njëjtit kanë therur me thikë viktimën mashkull kosovar. Viktima ka pranuar tretman mjekësor në QKMF Podujevë dhe më pas është dërguar për në QKUK Prishtinë. Njësi policor në vendin e ngjarjes ka konfiskuar një thikë dhe një veturë. Me vendim të prokurorit dy të dyshuarit dërgohen në mbajtje” ishte thënë në raportin policor të 15 janarit 2024. Nga një video-incizim që është publikuar në rrjete sociale është parë se i riu fillimisht ishte goditur me veturë nga dy persona të dyshuar e më pas e kishin goditur me mjete të forta disa herë.

Kulmi i komunës së Prishtinës me ndërtim pa bazë dhe mbetje të materialeve

PRISHTINË, 22 JANAR - Kulmi i objektit të ri të komunës së Prishtinës është cilësuar se nuk është ndërtuar në bazë të standardeve të ndërtimit. Ekspertët të cilët kanë vlerësuar situatën me elementet e para kanë thënë në konferencë për medie se kulmi është ndërtuar me mbetje të materialeve ndërtuese. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se komuna do të realizojë edhe vlerësime të tjera, por fillimisht është dashur realizimi i një vlerësimi fillestar.

“Duhet ekspertizë urgjente e preliminare për të ditur se çka e ka shkakton këtë problem me



kulmin e ndërtesës. Kam ftuar ekspertët e fushës, Visar Gecin e Gëzim Kastratin, që i kam

parë si profesionistë që veprojnë jashtë komunës, për ta analizuar e për të na dhënë

një gjendje preliminare për rrëzimin e kulmit. Problemi me kulm ka qenë edhe më parë, pra ka ndodhur në vitin 2017”, ka thënë Rama.

Më tutje, ai e ka njoftuar publikun se viktimat e cila është lënduar nga rënia e kulmit të objektit, Elza Ujkani, ka rrezikshmëri të lartë shëndetësore. “Për fat të mirë gjendja është stabile, por ende është në rrezikshmëri të lartë. Jemi në kontakt çdo ditë me doktorët. Kam qenë në kontakt me familjen e saj”, ka thënë Rama. Ndërsa arkitekti Visar Geci, i cili është angazhuar ekspert i jashtëm, ka dhënë detaje për

hulumtimet e para të objektit. “Kulmi ka rënë sepse struktura me të cilën është ndërtuar kulmi nuk është në bazë të standardit. Problemi ka qenë te binjakët të cilët e kanë mbajtur kulmin. Ata vetëm kanë pushuar në mur”, ka thënë Geci. Ai ka treguar se dyshohet që kulmi është ndërtuar nga mbetjet e materialeve të ndërtimit të objektit. “Materiali që është përdorur nuk është i përpunuar, nuk është i lyster as i trajtuar. Po dyshojmë mos është mbetje e ndërtimtarisë sa ka qenë duke u ndërtuar komplet objekti”, ka thënë Geci.

Sindikata e “Trepçës” kërkon nga minatorët ta ngrehin zërin për kushte më të mira

Mitrovicë, 22 janar - Para disa ditësh 13 minatorë janë lënduar si pasojë e rrjedhjes së acidit sulfurik në Minierën e Stan-Tërgut. Me këtë rast, Sindikata e Pavarur e Minatorëve të “Trepçës” ka kërkuar të hënën nga minatorët ta ngrehin zërin për kushte më të mira. Kjo sindikatë ka theksuar se minatorët nuk janë vetëm simbol nderi, por edhe i kujtesës

dhe sakrificës. “Lëndimet në trupat tanë dhe plagët që mbajmë nuk janë thjesht simbole nderi, ato janë kujtesë të sakrificave që bëjmë në emër të përpjekjes për përparim. Duhet kujtuar se lëndimi i çdo minatori nuk është vetëm një luftë personale, është një shqetësim kolektiv që kërkon vëmendjen tonë. Sindikata ka thënë se këto lëndime kanë

ndodhur pikërisht dhjetë ditë pas grevës së tyre dhe se kjo dëshmon që kjo grevë simbol i përpjekjes për ndryshime pozitive në shoqërinë tonë dhe se kërkesat e minatorëve kanë qenë të drejta”, është thënë në reagimin e kësaj sindikate. Sipas kësaj sindikate, minatorët e “Trepçës” nuk janë duke u vlerësuar mjaftueshëm nga institucionet shtetërore.

“Pavarësisht sfidave me të cilat përballemi, le të mos e harrojmë krenarinë që vjen nga të qenit minatorë. Puna jonë është thelbësore dhe qëndrueshmëria jonë është e pakrahasueshme. Është përmes vendosmërisë sonë kolektive që ne mund të kapërcejmë vështirësitë që na rrethojnë. Le të jetë kjo një thirrje për ditë më të mira në vazhdim”, është



thënë në reagimin e Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të “Trepçës”.

FSK-ja përfundon trajnimin me kontingjentin turk

Gjakovë, 22 janar - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka përfunduar trajnimin “Harr 66”. Ky trajnim është realizuar në kuadër të bashkëpunimit me kontingjentin turk në poligonin e stërvitjes në Babaj Bokës. Kështu ka bërë me dije FSK-ja përmes një njoftimi për medie, duke

theksuar se ky trajnim është realizuar nga instruktorët e kontingjentit turk që shërbejnë në Kosovë. “Trajnimi njëjavor qëllim kishte ngritjen e kapaciteteve luftarake të personelit të FSK-së, nga Regjimenti i Dytë i Forcave Tokësore (R2K), ku në kuadër të planit të trajnimit është realizuar

edhe qitja reale për t’i testuar aftësitë e fituara nga trajnimi. Në përfundim të trajnimit të pranishëm ishin shefi i shtabit të KFT-së, kolonel Valdet Berisha, komandanti i regjimentit të dytë të KFT-së, nënkolonel Jaser Mulla, instruktorët dhe përfaqësues nga kryesia e këshillit turk”, ka njoftuar FSK-ja.



Operacioni ‘Tempulli 2’, goditen shtatë grupe kriminale dhe arrestohen 273 persona

Tiranë, 22 janar - 273 persona janë vënë nën prangat e Policisë së Shtetit, në fazën e dytë të operacionit “Tempulli 2”, i cili ka qenë i shtrirë në disa qytete të Shqipërisë, me fokus goditjen e shpërndarjes së drogës. Në një prononcim për mediet nga Gjimnazi “Sami Frashëri” në Tiranë, kreu i Policisë së Shtetit, Muhamet Rrumbullaku, ka njoftuar se në total janë goditur anëtarët e shtatë grupeve kriminale që merreshin me shpërndarjen dhe tregtimin e lëndëve narkotike. “Policia e Shtetit, mbi bazë të një organizimi absolutisht profesional, ka arritur ta finalizojë arrestimin, ndalimin dhe arrestimin në flagrancë, pra të tre nocionet, të 273 shtetasve. Janë sekuestruar një sërë provash materiale që dokumentojnë aktivitetin e tyre kriminal në drejtim të shpërndarjes dhe tregtimit të lëndëve narkotike...



Mund t’ju themi që për këtë rast kemi të goditur anëtarët e shtatë grupeve kriminale”, ka thënë Rrumbullaku.

Ai ka theksuar se faza e dytë e operacionit nuk lidhet vetëm me shkollat, por me të gjitha zonat komunitare në të gjitha qytetet e

Shqipërisë. “Mund t’ju them se faza e dytë e operacionit nuk lidhet vetëm me shkollat, por me të gjitha zonat komunitare të të gjitha qyteteve të Shqipërisë, Tiranën, Durrësin, Shkodrën, Vlorën, Elbasanin, Korçën. Fokusi i Policisë së Shtetit, në drejtim të sigurimit të të rinjve, ka qenë goditja e këtij fenomeni në zonat e banimit të të gjithë adoleshentëve dhe problematikave të ndryshme që kanë adresuar qytetarët shqiptarë”, ka thënë ai. Ndërsa ministri i Brendshëm Taulant Balla ka thënë se në këtë fazë të dytë të operacionit është kapur një sasi e madhe lëndësh narkotike si dhe janë sekuestruar shumë armë pa leje. “Kemi arritur të realizojmë një fazë të dytë të operacionit kombëtar. Ka disa suksese në fakt. Do të nënvizojë se ka qenë një operacion i madh, por suksesi i parë lidhet me faktin që nuk

kemi pasur asnjë rrjedhje informacionesh dhe numri i madh i urdhrave të ndalimit janë realizuar dhe ndërkohë që ne flasim, forcat e policisë janë në terren duke vijuar punën. Jo pa qëllim jemi pranë një shkolle të mesme, se na duhet domosdoshmërisht ta rritim praninë tonë në territor për të garantuar sigurinë në shkollë. Dua të vlerësoj se edhe sasia e lëndëve narkotike është shumë e madhe, krahasuar me pritshmëritë, ndërkohë vazhdon puna jonë në luftën kundër armëmbajtjes pa leje. Kemi sekuestruar një numër të konsiderueshëm”, ka thënë Balla. Po ashtu, ai ka theksuar se do të forcohet me ligj pakoja e sigurisë në shkollë si dhe çdo formë e armëmbajtjes pa leje në vend. “Do të filloj edhe diskutimi publik. Do të marrë fund edhe shqetësimi i krimeve në familje”, ka thënë Balla.

26 vjet nga sulmi i familjes Jashari, Nura me bashkëpunëtorë nderojnë të rënë në Prekaz



Skenderaj, 22 janar - Me homazhe në Kompleksin Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz, është kujtuar sulmi i dytë mbi familjen Jashari në 26-vjetorin e këtij akti të forcave policore dhe ushtarake serbe mbi familjen e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Adem Jashari. Me këtë rast, kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, drejtorët komunalë dhe përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së degët në Skenderaj, i

kanë nderuar dëshmorët e kombit me një minutë heshtje si dhe kanë vendosur buqeta me lule të freskëta mbi varret e heronjve. “Lavdi e përvetshme sakrificës dhe heroizmit të familjes Jashari!”, ka njoftuar komuna e Skenderajt. Më 22 janar 1998, në orët e hershme të mëngjesit, nga Fabrika e Municionit të Gjuetisë, rreth 500 metra larg shtëpive të lagjes Jashari, kishin lëvizur forca të policisë serbe, të cilat ishin drejtuar drejt kullës së Jasharëve

për ta sulmuar atë me armë të llojeve të ndryshme. Meqë atë natë Adem Jashari nuk ndodhej në shtëpi, rezistencë sulmit të policisë serbe i kishin bërë Shabani e Hamza me nipa dhe mbesa. Sulmi i tretë i Serbisë në familjen Jashari kishte ndodhur më 5 mars 1998. Pas një lufte që kishte zgjatur tri ditë, kishin rënë heroikisht 59 anëtarë të familjes Jashari, përfshirë edhe komandantin legjendar të UÇK-së, Adem Jashari.

Haxhiu dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile bisedojnë për reformën në drejtësi

Prishtinë, 22 janar - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pritur në takim përfaqësuesit e shoqërisë civile me të cilët ka diskutuar për një sërë çështjesh që ndërlidhen me reformën në drejtësi, dhunën në familje, krimet e luftës, fuqizimin e profesioneve të lira dhe shërbimet sociale dhe familjare. Në këtë takim ministrja Haxhiu

ka folur për vazhdimin e punës pas publikimit të aktgjykimit të plotë lidhur me vetingun, reformën në sistemin prokurorial, plotësimin ndryshimin e Kodit Civil, digjitalizimin për Provimin e Noterisë dhe Jurisprudencës, zbatimin e Strategjisë kundër dhunës dhe rregullimin e fuqizimin e mekanizmave si:

QPS-të, strehimoret, OJQ-të e licencuara që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Ministria Haxhiu i ka falënderuar përfaqësuesit e shoqërisë civile për punën e tyre dhe ka premtuar transparencë dhe vazhdimësi të bashkëpunimit në hartimin e politikave të Ministrisë së Drejtësisë.



Ministri Peci merr pjesë në forumin global për ushqim dhe bujqësi në Gjermani



BERLIN, 22 JANAR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, në marginat e Forumit Global për Ushqim dhe Bujqësi (GFFA) që është duke u mbajtur në Berlin, ka zhvilluar një takim zyrtar me homologët e tij me të cilët ka bashkëbiseduar rreth sukseseve dhe sfidave në sektorin e bujqësisë dhe thellimit të bashkëpunimeve ndërshtetërore.

“Me ftesë të ministrit Federal për Ushqim dhe Bujqësi të Gjermanisë, Cem Ozdemir, jam pjesë e Forumit Global për

Ushqim dhe Bujqësi, me temën ‘Sistemet ushqimore të së ardhmes sonë: Bashkimi i forcave për një botë me zero uri’. Nga sot ky forum filloi punimet e veta në Berlin. Në mesin e 70 ministrave nga e mbarë bota, së bashku do t'i shpalosim idetë rreth sigurisë ushqimore, hapat e deritanishëm dhe strategjitë e politikave tona kundrejt një sektori të zhvilluar e të qëndrueshëm të bujqësisë”, ka shkruar Peci në “Facebook”. Peci ka thënë se ka shfrytëzuar rastin që me homologë nga

vendet e rajonit dhe më gjerë të bashkëbisedojë rreth sfidave dhe sukseseve të përbashkëta, themelimit të marrëdhënieve ekzistuese si dhe krijimit të urave të reja të bashkëpunimit. “Në kuadër të këtij forumi pata rastin ta takoj komisionarin për bujqësi në BE, Janusz Wojciechowski, të cilin e njoftova për progresin e deritanishëm në sektorin e bujqësisë si dhe hapat e ndërmarrë drejt hapjes së procesit për akreditim të AZhB-së me qëllim të akreditimit në IPARD”, ka shkruar Peci.

KEDS-i vjet kapi 6 715 konsumatorë duke vjedhur rrymën, njëri nga ta vodhi mbi 52 mijë euro

PRISHTINË, 21 JANAR - KEDS-i ka njoftuar se vetëm përgjatë vitit 2023, 6 715 konsumatorë-keqpërdorues të energjisë elektrike janë detyruar t'i rikthejnë humbjet. Sipas kësaj kompanie, vlera më e madhe që një konsumator komercial është detyruar t'ia kthejë asaj në kuadër të rikthimit të humbjeve vitin e kaluar është 52 489 euro. “Vetëm përgjatë vitit 2023, nga afro 100 mijë kontrole, KEDS zuri fiks 6 715 konsumatorë-keqpërdorues duke e vjedhë energjinë elektrike. Për këtë periudhë ata janë obliguar t'i rikthejnë

humbjet, që konsiderohet hapi i parë në kuadër të një sërë pasojash që i presin ata. Fenomeni i keqpërdorimit të energjisë elektrike që në praktikë klasifikohet si humbje komerciale, është i barabartë me diferencë ndërmjet energjisë së konsumuar dhe energjisë së faturuar. Humbjet komerciale po shkaktohen nga lidhjet direkt në rrjet, manipulimet në njehsorët elektrikë dhe metoda të tjera klandestine të devijimit nga pika matëse nga konsumatorë të pandërgjegjshëm”, thuhet në një njoftim të kësaj kompanie”,

ka njoftuar KEDS-i.

Kjo kompani ka theksuar se është duke vazhduar të realizojë rreth katërqind kontrole në ditë në mbarë Kosovën për identifikimin e keqpërdoruesve të energjisë elektrike, duke e rritur numrin e ekipeve të kontrollit. Në këtë kontekst, KEDS-i u ka bërë thirrje të gjithë konsumatorëve të mos e keqpërdorin energjinë elektrike, “sepse herët ose vonë duhet të paguajnë për dëmet dhe e vetmja formë e mosndëshkimit është përdorimi i ligjshëm i saj”.



Rregullorja e re e BQK-së, Mehmeti: Dinari ka qenë antiligjor, euro është valuta zyrtare e Kosovës

PRISHTINË, 22 JANAR - Ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se në vendin tonë vetëm euro është valuta zyrtare dhe se ndalimi i valutave të tjera nuk mund të bëhet me rregullore përderisa ekziston ligji. Mehmeti ka thënë se në Kushtetutën e Kosovës tregohet qartë se duhet të përdoret vetëm një valutë e vetme dhe se ndalimi i dinarit ka ndodhur që nga viti 1999, në kohën e konvertimit të markës gjermane. “Që nga paslufta çështja e dinarit ka qenë shumë sfiduese në Republikën e Kosovës dhe për këtë arsye në vitin 1999, më kujtohet saktë, ka qenë një rregullore. Në atë kohë është përdorur marka gjermane, e cila



ishite valutë zyrtare në Kosovë dhe nuk ka pasur valuta të tjera. Më pastaj, ju e dini konvertimi kur ka ndodhur prej markës gjermane në euro, me rregulloren 2001/24. Euro sipas kësaj rregullore është

valuta zyrtare për territorin e Kosovës. Pastaj kjo çështje është e rregulluar me Kushtetutë, më saktë me nenin 11-të të saj. Pastaj me nenin 16, me nenin 17 dhe 18 të Ligjit të Bankës Qendrore, më

saktësisht neni 16 specifikon kur thotë se euro ‘është valuta e vetme që do të përdoret’, ka thënë Mehmeti për “EO”. Më tutje, Mehmeti ka treguar edhe dallimin se kur dhe ku mund të përdoren valutat që nuk janë në vlerën euro. “Valutat e tjera mund të përdoren për ruajtje fizike, në llogari për pagesa ndërkombëtare, por jo më shumë. Pra kemi një valutë të vetme zyrtare që është valuta euro. Pa dashur ta elaboroj rregulloren, ajo e adreson atë çfarë thuhet në ligj e që ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare në maj të vitit 2012”, ka thënë Mehmeti. Ndërsa për ndalimin e kartëmonedhave 500-she, Mehmeti e ka cilësuar si vendim të kahershëm. Ai ka thënë se ndalimi

i këtyre kartëmonedhave ka ndodhur në kohën sa ka qenë guvernator i BQK-së. “Ndër të tjera, në këtë rregullore përmendet edhe çështja e kartëmonedhës 500-euroshe. Mediet e interpretuan se kinse ‘nuk ka më kartëmonedha 500 euro’ që, faktikisht, ka vite më herët që Banka Qendrore Evropiane ka marrë vendim ta ndalojë prodhimin e këtyre kartëmonedhave dhe ka vite më herët kur ne kemi kërkuar prej institucioneve financiare dhe bankare që duhet t'i pranoni kartëmonedhën 500 euro, mirëpo nuk keni të drejtë ta hidhni në qarkullim, por ato duhet të kthehen në BQK e më pastaj të rikthehen në origjinën ku janë emetuar”, ka thënë Mehmeti.

Rama sot do t'i paraqesë 20 projekte për kryeqytetin

PRISHTINË, 22 JANAR - Sot (e martë) do t'i nisë punimet forumi më i madh i biznesit “Kosova Business Forum”. Temë kryesore do të jetë “Prishtina 2030 - udhëheqja e rrugës drejt një kryeqyteti të së ardhmes”. Punimet e këtij forumi do të zgjasin tri ditë. Në ditën e dytë të mbajtjes së

kësaj ngjarje, para pjesëmarrësve do të deklarohet edhe kryetari i Prishtinës, Përparim Rama. Ai ka bërë me dije se në këtë forum do t'i paraqesë disa projekte të rëndësishme para bizneseve ndërkombëtare. “Me datë 24 janar 2024 do të prezantoj para shumë

bizneseve ndërkombëtare 20 projekte të rëndësishme të cilat synojnë ta ndryshojnë trajektoren e zhvillimit të qytetit tonë në vitet në vijim. Këto projekte përfshijnë infrastrukturën, teknologjinë, zhvillimin urban, arsimin dhe shëndetësinë në kryeqytet”, ka thënë Rama.



Iluzioni i së ‘vërtetës’ në ‘Reality TV’

Çdo vit, me nisjen e sezoneve të reja të programve ‘Reality,’ në fakt shfaqen paralelisht dy spektakle të këtij lloji: i pari, ai që prezantohet rregullisht çdo javë dhe i dyti, ai i kritikës së këtyre programeve. Të dy përfshijnë persona realë në situata, të paktën në dukje, të vërteta. Por, mes tyre ka një të përbashkët edhe më domethënëse. Ndërsa servirësit e programeve ‘Reality’ kanë çdo arsye të na inkurajojnë të ushqyerit në kazanin e ideologjisë së konsumerizmit të shfrenuar, duket se kritikët i shqetëson vetëm “moralin,” çfarëdo kuptimi të ngushtë që i jepet këtij koncepti. Për të dy palët, shikuesit dhe shoqëria në përgjithësi, s’janë tjetër veçse një masë idiotësh të pavetëdijshëm që duhen ushqyer ose me ideologjinë e konsumerizmit, ose me një lloj edukimi gati-gati të dhunshëm vlerash morale. E gjitha ngjan më tepër me një lloj beteje kulturore se cila palë do t’i imponojë vlerat e saj pjesës tjetër të shoqërisë.

Përtej ‘vuajerizmit.’ Tundimi për të gjykuar të tjerët

Suksesi i programeve ‘Reality’ në tërheqjen e vëmendjes së një numri të madh shikuesish i atribuohet në mënyrë të gabuar ‘vuajerizmit,’ marrjes së një kënaqësie perverse nga të parit e të tjerëve.

Së pari, ‘vuajeristët’ ndiejnë kënaqësi kur “viktimat” e tyre janë të pavetëdijshme se po shihen. Është gjithmonë fjala për një lojë pushteti. Ti që sheh, ke pushtet mbi atë që vijon rutinën e tij, pa e ditur se po shihet. Në rastin e programeve ‘Reality,’ kjo bie poshtë sepse personazhet janë qysh në fillim të vetëdijshëm se po shihen. Madje, mund të thuhet se kjo është arsyeja e pjesëmarrjes së tyre në program dhe kënaqësia e të shndërruarit të vetes në personazh.

Së dyti, ne përfetojmë një lloj identifikimi me pjesëmarrësit në këto programe e, mbi të gjitha, ndiejmë simpati për situatat në të cilat vendosen. Si do të reagonim ne, po të gjendeshim në rrethana të ngjashme? Si kam reaguar kur kam qenë në të njëjtën situatë? Por, më e rëndësishmja, është se programe të tilla i japin shikuesve mundësinë të gjykojnë tjetrin. Në fakt, kapaciteti për të gjykuar është ndoshta e vetmja e “vërtetë” e këtyre programeve. Ankthi i përditshmërisë, monotonia dhe zbrazëti me të cilën përballemi në pjesën më të madhe të jetës, kërkojnë një qetësues të fortë. Diçka që të na garantojë se pavarësisht gjithçkaje, në

mbrëmje mund t’i shtriqim këmbët mbi tavolinën e mesit, të vetëkënaqur që nuk jemi aq “rëndë” sa njerëzit që shohim të grinden në TV. Ah, sikur jeta të ishte aq e thjeshtë sa një përmbledhje ditore, me momentet më interesante të edituara me kujdes dhe të renditura në të atillë mënyrë, që nuk lë vend për ankth e mëdyshje. Për më tepër, kur është hera e fundit që drejtuesit, opinionistët, apo edhe pjesëmarrësit e këtyre programeve kanë pranuar se nuk e dinë diçka? Kur është hera e fundit që kanë refuzuar të japin këshilla sepse mund të mos jenë ndodhur në situatën për të cilën po pyeten? Përkundrazi, ata duken të gjithë të etur për të ofruar këshilla dhe zgjidhje të gatshme për gjithçka. Ndaj, ‘vuajerizmi’ nuk është termi i duhur për të përshkruar kënaqësinë që ne marrim nga ndjeka e programeve ‘Reality.’ Është mundësia për të gjykuar të tjerët ajo që në fakt shijojmë. Mundësia për t’i gjykuar të tjerët në mënyrë sipërfaqësore, përmes situatave të ndërtuara me të atillë kujdes, që të na duhet të mendojmë sa më pak. Pavarësisht marrëdhënieve dhe konflikteve sado dramatike që ndërtohen në anën tjetër të ekranit, në fund gjithçka zgjidhet. Ka gjithmonë një përgjigje. Ti vetëm nuk duhet të mendosh.

Realitet i Strukturuar

Në nisje të thujse çdo programi ‘Reality,’ prezantuesit nuk lodhen asnjëherë së përsërituri se ai [programi] ofron një copëz realiteti të pafiltruar. Ndryshe nga filmi, letërsia apo teatri, këtu pjesëmarrësit janë njerëz të vërtetë në situata të vërteta. Megjithatë, nën sipërfaqen e situatave në dukje spontane shtrihet një rrjet i tërë teknikash produktioni që formësojnë dhe shtrembërojnë narrativat sipas oreksit të audiencës për dramë dhe argëtim.

Ndonëse të promovuara si spektakle argëtuese pa skenar, këto programe janë të stisura thujse në çdo fazë të tyre. Procesi përfshin përzgjedhjen e kujdesshme të pjesëmarrësve, planifikim strategjik dhe mbi të gjitha, editim të përkushtuar për të ndërtuar narrativa sa më tërheqëse. Me pak përjashtime, pjesa më e madhe e programeve ‘Reality’ regjistrohen dhe gjatë xhirimit situatat përsëriten disa herë për të arritur emocionin e duhur. ‘Big Brother’ është nga të pakët programet që ofron një dritare 24-orëshe në jetët e pjesëmarrësve por, në shumë vende produktioni ka hequr dorë edhe nga kjo, duke u kufizuar vetëm tek spektakli javor i eliminimeve. Për më tepër, ‘Reality TV’

paraqet një version të idealizuar të jetës, ku konfliktet zgjidhen lehtësisht brenda një kornize kohore 30-minutëshe, ose brenda një episodi një-orësh. Sfidat që hasen dhe marrëdhëniet e ndërtuara nga pjesëmarrësit thjeshtohen për t’iu përshtatur kornizave të narrativës që i duhet shtyrë publikut, larg ndërlikimit, rrëmujës dhe mediokritetit të jetës së përditshme. Jeta në fakt përbëhet nga një përzierje eksperiencash të rëndësishme dhe të rëndomta, të cilat kontribuojnë në pasurinë dhe kompleksitetin e përvojës njerëzore.

Kemi të bëjmë kështu me realitet të strukturuar. Jo vetëm që kalohet në procese të gjata përzgjedhjeje të konkurrentëve dhe ndërtimit të situatave në të cilat ata do të vendosen, por kalohet në një proces edhe më të kujdesshëm editimi (montimi). Edhe nëse nuk kemi të bëjmë paraprakisht me skenarë të mirëfilltë, ekziston gjithmonë arti i editimit selektiv. Orë të tëra materiale shikohen në sitë për të zgjedhur momente specifike, të cilat do të shërbejnë për të ndërtuar narrativa koherente dhe shpesh sensacionale. Përmes editimit, producentët manipulojnë kohën, ri-rendisin sekuencat e madje fabrikojnë kontekstet e ngjarjeve për të krijuar tension. Çfarë mund të ketë qenë një bisedë e zakonshme ose një moment i rëndomtë, transformohet në një moment kulminant që formëson të gjithë narrativën. Në thelb, ‘Reality TV’ është diçka e përlogaritur me kujdes, mjaft larg idesë se kemi të bëjmë me një dritare në jetët reale të disa bashkëqytetarëve. Ajo çfarë i paraqitet shikuesit është në fakt një version i kurrar i ngjarjeve dhe i manipuluar me mjaft talent për të shfaqur narrativa që përputhen me pritshmëritë e audiencës për argëtim. Mendon ndokush vërtet që operacione të tilla fitimprurëse do t’i lireshin në dorë spontanitetit?

Shitja e Iluzioneve: Ekuilibri midis ‘Reality TV’ dhe Reklamave

Shpesh kemi bindjen e gabuar që ne, shikuesit, jemi klientët e programeve të ofruara nga industria televizive e argëtimit. Të shtrënguar në disa raste nga kritikë, prodhuesit e këtyre programeve sjellin si argument se kjo është ajo çfarë kërkon publiku. Thënë më thjesht, jetojmë në një shoqëri të lirë ku tregu, klienti, kërkesa, vendosin se çfarë duan, kurse prodhuesi apo shitësi është i detyruar t’ua ofrojë.

Nga ana tjetër, një pjesë e mirë kritikëve pretendon se media, përfshi edhe programet



argëtuese, duhet të luajnë një rol më edukativ dhe të mos përqendrohen vetëm tek fitimi. Kjo është kritika më jo-kapitaliste, edhe pse në shumicën e rasteve vjen nga një pjesë e shoqërisë që ka një adhurim gati-gati fetar për mitin e ekonomisë së tregut. Është e vërtetë që ne, si shikues, jemi pjesë e ekuacionit të tregut por, harrojmë se në shumicën e rasteve ne nuk i paguajmë televizionet për të ndjekur programet e tyre, qoftë informuese apo argëtuese. Ne nuk jemi as blerës e as ofrues, por produkti që shitet. Vëmendja jonë iu shitet sponsorëve, të cilët më pas, përmes reklamave do të na shesin produktet dhe shërbimet e tyre. Për këtë, fillimisht vëmendja duhet tërhequr e më pas përpunuar, për të fabrikuar dëshirat e konsumatorëve. Është një lloj rrethi vicioz ku media trajnon shikuesit, të cilët trajnojnë median, e cila na trajnon ne për të kërkuar thujse gjithmonë të njëjtat gjëra. Një nga strategjitë kyçe të reklamuesve është shfrytëzimi i iluzionit të realitetit që vizatojnë programet ‘Reality.’ Shikuesit tërhiqen nga ideja se janë duke parë përvoja njerëzore të singerta e të pafiltruara. Nga ana tjetër, reklamuesit vendosin në mënyrë strategjike produktet në këto narrativa, duke e asociuar atë që shesin me eksperiencat në dukje të vërteta që shfaqen në ekran. Ky lloj integrimi i të dyjave megjullon vijën ndarëse mes argëtimit dhe reklamave, duke e bërë produktin e promovuar të duket si pjesë e natyrshme e spektaklit.

A ka një rrugëdalje?

Në përpjekje për të na ofruar rrugëdalje, një pjesë e kritikëve kulturorë apo kritikëve mediatikë, kërkojnë ose ndërhyrje rregulluese nga institucionet kulturore shtetërore, ose pretendojnë në mënyrë deri diku absurde për një lloj vetë-ndriçimi moral të prodhuesve të këtyre

programeve. Por, në një shoqëri të lirë, ndërhyrja e institucioneve shtetërore, aq më tepër në media, mund të perceptohet si censurë. Ekziston gjithashtu rreziku që kjo “censurë” të shtrihet më pas në fusha të tjera të kulturës dhe argëtimit. Diskutimi moral është gjithashtu absurd, pasi vlerat morale të një grupi njerëzish nuk mund t’i imponohen pjesës tjetër të shoqërisë. Aq më tepër, kur morali për të cilin diskutohet, shpesh është një koncept i ngushtë që, jo vetëm nuk e zgjidh problemin, por rrezikon ta përshkallëzojë atë në drejtime që ndoshta as nuk i kemi imagjinuar.

Megjithatë, ekziston edhe një zgjidhje më e qëndrueshme, siç është ajo e ofruar nga teoricieni i medias dhe filozofi kanadez, Marshall McLuhan me “ndihmën” e Edgar Allan Poe. Është fjala për metaforën e vorbullës, e përfutur nga tregimi ‘A Descent into the Maelstrom’ i Poe-s, ku përshkruhen përpjekjet përpjekjet e tre peshkatarëve për t’i shpëtuar vorbullës që rrezikon t’iu marrë jetën në det: “Në fillim, ai pa vetëm tmerrin e spektaklit të vorbullës. Më pas, në një moment zbulimi, kuptoi se vorbulla ishte diçka e bukur dhe mahnitëse. Duke vëshguar se si objektet tërhiqeshin drejt qendrës së saj, ai vuri re se ‘sa më të mëdha objektet, aq më shpejt binin brenda saj.’”

Për McLuhan, masmedia ishte një vorbullë e fuqishme që e tërheq shoqërinë drejt sjelljeve të reja, që rrezikojnë ta trullojnë apo edhe shkatërrojnë atë përfundimisht. Ndaj, ai sugjeron studimin e formave dhe efekteve të kësaj vorbule në shoqëri, si strategji shpëtimi dhe mbijetese. Ndoshta, rrugëdalja nuk është protesta dhe zemërimi por, shndërrimi ynë nga shikues të spektaklit mediatik, në shikues të anagazhuar të marrëdhënies tonë me median dhe industrinë e argëtimit.



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN
 SEKURIT
 PILKINGTON
 Enveri

Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Kuvend
 Servisim
 Perfaq



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Gjumnastet e Kosovës përmbyllin me sukses kampin njëjavor në Turqi



“Epoka e re”

PRISHTINË, 22 JANAR - Dymbëdhjetë gjumnaste nga Kosova kanë përmbyllur me sukses kampin stërvitor njëjavor në Turqi. Ato kanë qenë të shoqëruar nga trajnerët e Kosovës si dhe janë përgatitur edhe nga trajnerët e kombëtares turke. Gjumnastet Hira Haziri, Fernaze Cakaj, Diellona Azemi, Jora Gërvalla, Sara Pllana, Rea Berisha, Bora Hoti, Vlera Gërguri, Elena Sefa, Vilëza Zeqiri, Kaltrina Thaqi dhe Valëza Rama, të shoqëruar nga Besnik Latifi,

Shkumbin Maqastena, Ard Kryeziu, Arlind Shaqiri, Doruntinë Ibrahimimi dhe Lisa Zeqiri, nga data 14-21 janar kanë shkëmbyer dhe përvetësuar përvojat e tyre në këtë kamp i cili ka rëndësinë e veçantë për këtë sport specifik. Ky kamp është mbështetur nga Federata e Gjumnastikës e Kosovës. Vlen të theksohet se vëmendje të madhe stërvitjeve të gjumnasteve të Kosovës i ka kushtuar edhe Federata turke, respektivisht kryetrajneri i kësaj federate dhe kryetari i saj. Ata kanë vizituar kampin ku ishte vendosur delegacioni i Kosovës. “Pas një jave të shkëlqyeshme stërvitjesh,

sot e përmbyllëm kampin stërvitor 1-javor në Turqi. Ekipi që u kujdes për dymbëdhjetë gjumnastet tona në kamp ishte i përbërë nga: Besnik Latifi, Shkumbin Maqastena, Ard Kryeziu, Arlind Shaqiri, Doruntinë Ibrahimimi dhe Lisa Zeqiri. Gjumnastet tona pjesëmarrëse ishin: Hira Haziri, Fernaze Cakaj, Diellona Azemi, Jora Gërvalla, Sara Pllana, Rea Berisha, Bora Hoti, Vlera Gërguri, Elena Sefa, Vilëza Zeqiri, Kaltrina Thaqi dhe Valëza Rama. Në emër të të gjithë ekipit, faleminderit të gjithëve për përkrahjen e pandërprerë!”, thuhet në njoftimin e Federatës së Gjumnastikës së Kosovës.

SHKURT

Proton Cable Prizreni shkarkon trajnerin Mihajlovski

Klubi i Basketbollit Proton Cable Prizreni ka mbetur pa trajner. Kjo skuadër ka njoftuar sot se ka ndarë rrugët me trajnerin Igol Mihajlovski. Gjatë kësaj jave ekipi prizrenas do ta emërojë trajnerin e ri. “Ndajmë rrugët me trajnerin Mihajlovski. Nga sot trajneri maqedonas Igor Mihajlovski nuk do të jetë timonier i klubit bardh e zi. Ky vendim erdhi pasi trajneri nuk arriti ta bindë menaxhmentin e klubit rreth punës së tij dhe i njëjti u shkarkua nga pozita që kishte. Gjatë javës do t'ju informojmë për timonierin e ri”, thuhet në njoftimin e klubit prizrenas.

Broja, objektivi kryesor i West Hamit

Armando Broja duket gjithnjë e më larg Chelseat, me sulmuesin shqiptar që nuk është më në planet e trajnerit Pochetino. Pas lajmit të “The Sun”, që theksoi se sulmuesi i kombëtares shqiptare do të largohet në huazim në janar dhe më pas do të shitet në verë, ka qenë “The Guardian” ajo që bërë me dije një tjetër lajm të bujshëm. Sipas prestigjiozes britanike, Broja është kthyer në objektivin kryesor të merkatos për West Hamin. Kjo gjë ka ardhur pasi Aston Villa ua refuzoi ofertën “Çekanëve” për Xhon Duran, e cila nuk shkonte në më shumë se 18 milionë paund. Duke parë nevojën e madhe për një sulmues, West Hami është i gatshëm të ulet në tavolinë me Chelsean dhe të nisë negociatat për Brojën, pasi në garë për të janë edhe Wolvesi dhe Fulhami.

Colturi, e pafat në garën e radhës në Jesna

Pas vendit të 13-të arritur ditën e shtunë në pistën sllovae të Jesnas, gara e radhës në këtë pistë nuk ka qenë me shumë fat për skiatoren shqiptare Lara Colturi. Ajo nuk ka mundur dot ta përfundojë garën e sllallomit zhvilluar ditën e diel. Colturi dha kohën 55”61 pas zbritjes së parë dhe arriti të kualifikohet mes 30 skiatoreve më të mira. Në zbritjen e dytë ajo nuk e përfundoi dot garën, duke mos dhënë dot kohë dhe duke u shkualifikuar pa mundur të marrë pikë. Gjithsesi, paraqitjet sezonale të Colturit kanë qenë shumë të mira, teksa po renditet gjithnjë e më shumë mes 15 skiatoreve më të mira në çdo garë. Deri më tani skiatorja kuqezi ka grumbulluar 127 pikë në garat e Kupës së Botës. “Brenda ose jashtë, nuk ka rrugë të mesme”, është komenti në rrjetet sociale i Lara Colturi pas kësaj gare, që tregon se ka kërkuar më shumë nga vetja në pistë.

Fillon Liga Unike Femrat

PRISHTINË, 22 JANAR - Në mesjavë, të martën dhe të mërkurën, do të zhvillohet xhironja e parë në Ligën Unike Femrat për edicionin e ri. Qysh në javën e parë do të kemi ndeshje interesante. Liga hapet me sfidën mes kampionit dhe ish-kampionit. Partizani është mikpritës i Prishtinës. Të dyja skuadrat synojnë fitoren. Skuadra tiranase është kampione aktuale, ndërsa ajo prishtinase e kishte fituar titullin e parë. Takim interesant shihet në mes të Bashkimit dhe Flamurtarit, dy skuadra me ambicie të mëdha në

këtë edicion. Të mërkurën zhvillohet sfida e fundit. Do të ndeshen Tirana me Penzën. Edhe në këtë edicion do të marrin pjesë gjashtë skuadra, tri më të mirat e Kosovës dhe po kaq të Shqipërisë, të renditura për edicionin e kaluar në ligat e tyre vendore. Gjithsej do të zhvillohen dhjetë xhiro. Secila do të përballlet me secilën si vendëse dhe si mysafire. Më pas do të zhvillohet Final 4, me katër skuadrat më të mira në renditje. Final 4 do të zhvillohet më 2/3 prill në Kosovë dhe do të përcaktohet kampioni i kësaj lige.



Fitorja e Guineas kthehet në tragjedi, humbin jetën 6 persona

Conakry, 22 janar - Ngjarja dramatike ndodhi pas ndeshjes së Kupës së Kombeve të Afrikës mes Guinesë dhe Gambias, të cilën e para e fitoi falë një goli të Camaras. Ishte suksemi i parë në këtë kompeticion për kombëtaren e drejtuar nga Diawara, ndaj ndezi gëzimin e tifozëve. Për fat të keq, lumturia u kthye në tragjedi, kur gjatë festimeve humbën jetën gjashtë persona për shkak të aksidenteve rrugore. Guinea u mblodh menjëherë rreth familjeve të viktimave, duke nisur thirrje të shumta për të siguruar që tragjedi të ngjashme të mos ndodhin më kurrë. Amadou Makadji, menaxher i medieve të Federatës së Futbollit të Guinesë, ka thënë: “E rëndësishme është që tifozët tanë dhe publiku të festojnë në mënyrë shumë të matur. Ata duhet të jenë shumë të kujdesshëm që të mos e vënë veten në rrezik, sepse objektivi i futbollit është të sjellë gëzim dhe jo t’i fusë familjet në zi”.



Davisi i Pejës sërish MVP në Superligë

PRISHTINË, 22 JANAR - Në javën e 18-të të Prince Caffë Superligës u zhvilluan përballje kryesisht të barabarta me fituesit që janë vendosur në fund. Peja fitoi derbin e kësaj xhiroje ndaj Golden Eagle Yllit, duke u rikthyer nga disavantazhi prej 18 pikëve për të fituar 72:77. Edhe këtë herë më i miri te kampionët e Kosovës ishte Justin Davis me 22 pikë e shtatë kërcime. Ai kontribuoi edhe me katër topa të vjedhur dhe një bllokadë. Sigal Prishtina, ndonëse jo pa vështirësi, mundi Istogun, ku qendra prishtinase, Fisnik Rugova, zhvilloi ndeshje të jashtëzakonshme me 21 pikë, 15 kërcime dhe pesë asistime. Fisi e kishte indeksin 35 apo më të lartën e kësaj xhiroje. Fitore shumë të vlefshme shënoi Bashkimi ndaj Proton Cable Prizrenit, ndërsa më i miri te Portokallezinjtë ishte Altin Morina me 17 pikë, pesë kërcime dhe tri asistime. Edhe Trepça jo pa vështirësi shënoi fitore. Këtë herë mendi Vëllaznimit, që ishte fitorja e 11-të radhazi, ndërsa te mitrovicasit u dalluan Darnell Edge me 22 pikë, dy kërcime e tri asistime dhe Dardan Kapiti me 16 pikë, katër kërcime dhe një asistim.



MVP	indeksi
Justin Davis (Peja) 22 pikë, 7 kërcime, / asistime, 21 indeksi	Altin Morina (Bashkimi) 17 pikë, 5 kërcime, 3 asistime, 21 indeksi
Top pesëshja	
Fisnik Rugova (Sigal Prishtina) 21 pikë, 15 kërcime, 5 asistime, 35	Justin Davis (Peja) 22 pikë, 7 kërcime, / asistime, 21 indeksi
	Darnell Edge (Trepça) 22 pikë, 2 kërcime, 3 asistime, 21 indeksi
	Dardan Kapiti (Trepça) 16 pikë, 4 kërcime, 1 asistim, 20 indeksi

Miami në krizë, triumfojnë Bostoni, Denveri dhe lakersat



HOUSTONM 22 JANAR - Kampionët e Denverit fituan me rezultat 113-104 ndaj Washingtonit dhe i afrohen gjithnjë e më shumë kreut të renditjes në Perëndim. Ndeshje e kontrolluar nga lojtarët e Nuggetsit, ku u dallua Nikola

Jokiç, autor i 42 pikëve dhe 12 reboundeve. Rikthehet te fitorja ekipi i lakersave, që mundi me shifrat 134-110 Portlandin. Russell me 34 pikë e Jamesi me 28 pikë ishin dy më të mirët për lakersat. Fitoi edhe ekipi tjetër i

Los Anxhelosit, ai i clippersave, që mundi me shifrat 125-114 Brooklynin. Hardeni me 24 pikë e Westbrook me 23 u dalluan për vendësit. Humbja e tretë radhazi për Miamin, që u mund me rezultat 105-87 nga Orlando në derbin e Floridas. Të gjithë titullarët e Orlandos realizuan mbi 10 pikë. Bostoni konsolidon kreun e renditjes në Lindje, shkëputur ndjeshëm nga rivalët, pas fitores me rezultat 116-107 në fushën e Houstonit. Për Celticsin u dallua Porzingis, autor i 32 pikëve.

REZULTATET	
Clippers - Brooklyn	125-114
Orlando - Miami	105-87
Washington - Denver	104-113
Houston - Boston	107-116
Phoenix - Indiana	117-110
Lakers - Portland	134-110

SHKURT

Allegri: Titulli? Asgjë e pamundur

Juventusi nuk fshihet më, as Max Allegri, aq më pak tifozët. Të gjithë besojnë tani se mund ta fitojnë titullin në Serinë A. “Zonja e Vjetër” përfitoi nga mungesa e Interit, mposhti pastër 3-0 në transfertë Leccen duke marrë kreun e klasifikimit pas javës së 21-të. Ky sukses dhe kreu i Serisë A bënë që është Allegri të reflektojë, tashmë edhe titulli nuk është tabu këtë sezon. “Nuk futboll nuk ka asgjë të pamundur. Duhet të jesh i vetëdijshëm, të kesh një objektiv të qartë në kokë dhe të punosh për ta bërë të pamundurën të mundur”, u shpreh Allegri, i cili përballë Lecces siguroi fitoren e 300 në Serinë A.

Mourinho në bisedime me Napolin

E ardhmja e Jose Mourinhos mund të jetë në Itali. Sipas raportimeve të medieve italiane, destinacioni tjetër i “Special One” mund të jetë Napoli. Ditët e fundit raportohet se ka pasur kontakte mes Aurelio De Laurentiis dhe agentit të trajnerit portugez, Jorge Mendes, në Arabinë Saudite dhe këtë javë vetë Mourinho do të takohet drejtpërdrejt me presidentin e Napolit. Trajneri portugez synon një rikthim të menjëhershëm në krye të një skuadre pas largimit nga Roma dhe do të pëlqente të qëndronte në Itali, në një klub me burime ekonomike më të mëdha se “verdhekuqtë” siç është Napoli. I kërkuar edhe nga klube të Saudi Pro League, Mourinho do të donte të qëndronte në Evropë dhe Napoli do të ishte vendi i duhur për t’u rikthyer.

Tri klube nga Premierë Liga e dëshirojnë Sanen

Tri klubet e Premierë Ligës, Liverpooli, Arsenali dhe Tottenhami, kanë treguar interesim për yllin e Bayern Munchenit, Leroy Sane. Anëtori gjerman ka kontratë me Bayernin deri në vitin 2025, por është i interesuar të largohet. Liverpooli në krye me Jurgen Kloppin po mendojnë për largimin e Mohamed Salah dhe ylli gjerman shihet si zëvendësues i egjiptianit që mund të transferohet në Arabinë Saudite. Në anën tjetër, Arsenali po e dëshiron Sanen për t’i shtuar cilësitë në radhët e veta dhe për të qenë edhe më konkurrues në Angli ashtu dhe në Ligën e Kampionëve. Skuadra tjetër që ka treguar interesim për Sanen është edhe Tottenham Hotspuri. Ky i fundit beson se gjermani përshtatet me mënyrën e lojës së “Spurs”-it. Megjithatë, Bayerni nuk pritet të heqë aq lehtë dorë nga ylli i saj.

Salernitana mund ta rikthejë Balotellin në Serinë A

Sulmuesi italian Mario Balotelli mund të rikthehet sërish në Serinë A. 33-vjeçari aktualisht luan në Turqi me Adana Demirsporin, me të cilin ka një kontratë deri në vitin 2025. Balotelli nuk luan që nga mesi i nëntorit për shkak të dëmtimit, që e detyroi t’i nënshtrohej një operacioni në gju pas tre golave në pesë paraqitjet e tij këtë sezon në Superligën turke. Menaxheri i lojtarit ia propozoi transferimin skuadrës së Salernitanës, e cila tregoi interesim. “Ekziston kjo mundësi, por është shumë herët për të folur për negociatë. Të shohim”, kanë cituar burime brenda klubit të Salernitanës. Ndërkohë vetë lojtari është ofruar të rikthehet pa pretenduar shumë financiarisht.

Alcaraz, Medvedev e Zverev, në çerekfinale të Australian Open

Janë mbyllur ndeshjet e raundit të katërt në grand slam të Australian Open, turneu i parë i madh i vitit që po zhvillohet në Melburn. Numri 2 në botë për meshkuj, spanjollë Carlos Alcaraz, avancon më tej pas fitores 3-0 (6-4, 6-4, 6-0)

ndaj serbit M. Kecmanoviq. Ndeshje e dominuar nga Alcaraz, që kualifikohet për në çerekfinale. Në çerekfinale shkon edhe rusi Daniil Medvedev, numri 3 në botë. Ai mundi 3-1 portugezin N. Borges (6-3, 7-6, 5-7, 6-1). Nuk

zhgënjeu hungarezi Hurbert Hurkacz (nr. 9), që mposhti 3-0 francezin A. Cazaux (7-6, 7-6, 6-4). Një biletë për më tej siguron edhe gjermani Alexander Zverev (nr. 6), që mundi 3-2 britanikun Cameron Norrie, në një ndeshje maratonë,

që zgjati mbi 4 orë (7-5, 3-6, 6-3, 4-6, 7-6). Te femrat befason tenistja ukrainase Dayana Yastremska, që shkon në çerekfinale edhe pse ka ardhur nga faza kualifikuese. Ajo mundi 2-0 bjellorusen Victoria Azarenka (7-6, 6-4), që ishte

favorite. Kualifikohet edhe çekja Linda Noskova, që përfitoi nga tërheqja në raundin e parë të ukrainases Elina Svitolina. Në çerekfinale shkon edhe rusja Alina Kalinskaya, që mundi 2-0 (6-4, 6-2) italianen J. Paolini.

QENDRA E KOMPETENCËS

"SHTJEFËN GJEÇOVI"

Prishtinë

Prishtinë 10000 Kosovë. Rruga " TIRANA" nr. 125 Tel. +383 (0) 38 613 026

Bazuar në nenin 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/1 – 138, i datës 28.02.2013 për arsimin dhe aftësimin profesional dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L – 143, i datës 13.12.2012, për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe në bazë të rregullores (MASHT) nr. 01/2017, të datës 02.02.2017, për planifikimin dhe shpenzimin dhe aftësimin profesional dhe arsimit për të rritur, Agjencia për Arsim, Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, shpall :

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) për vijimin e mësimit për të rritur në Qendrën e Kompetencës “SHTJEFËN GJEÇOVI” në Prishtinë, për vitin shkollor 2023/2024, afati i Qershorit

Për këto profile :

- Dirigjimi kompjuterik i makinave
- Metalpunues
- Automekanik
- Mekatronikë
- Instaluesi i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ngrohjes dhe klimatizimit
- Operator Prodhimi
- Saldator
- Konfeksioner
- Rrobaqepës
- Transport rrugor
- Trafik rrugor
- Transpor hekurudhor (Drejtuës i trenave, Lëvizje e trenave, Tërheqje e trenave).
- Floktar

KUSHTET :

Regjistrimi i vijuesve në programin arsimi për të rritur bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënës të rregullt siç është paraparë në Ligjin nr.04/L – 143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve të MASHT-it, UA 11/2011, UA 16/2011 i datës 30.12.2011 ; UA 12/2014, i datës 05.05.2014, dhe UA 13/2014, i datës 05.05.2014.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët kanë moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Dëftesa e klasëve të kryera paraprake
- Certifikata e lindjes
- Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të UA 11/2011, i datës 30.12.2011.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- a) Për regjistrim të vitit për një klasë100,00 €
- b) Për praktikë profesionale50,00 €
- c) Për provim diferencial 10,00 €
- d) Provimi përfundimtar /certifikata – diploma50,00 €

Pagesat bëhen në institucionet financiare sipas kodit të shkollës.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin “Arsimi dhe aftësimi për të rritur” janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Drejtori: Blerim Gërvalla



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 15.01.2024 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-23-16

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça SH.A.

Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Behxhet Nimani
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com
Telefoni: +383 28 538 050
Faks: +383 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qera e hapësirave, Zyreve në Teminalin Doganor

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë

Data e shpalljes: 22.01.2024

Sqarimi: 6.02.2024

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 06.02.2024
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Origjinali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 06.02.2024 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Departamenti i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës te pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madhe apo i barabarte me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nikoll Radi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Agron Syla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Arbër Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10, 11, 12 dhe diplomën e sh.m. “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.

- Alfred Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10, 11, 12 të sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Ulvije Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m. “Mustafa Bakija” nga kl. I-IX.

- Rasim Kokalla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e A.P. “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Law Firm Consulting E Hoti” L.L.C. me seli në Gjilan, me pronar Emine Hoti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811497769 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Law Firm Consulting E Hoti” L.L.C. Gnjlane, sa vllasnikom Emine Hoti, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811497769 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Law Firm Consulting E Hoti” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Emine Hoti, has come to the decision to quit its business: 811497769 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

